

URDHËR
Nr. 238, datë 11.9.2020

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Adrian Kamenica, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2020.

3. Urdhri me nr. 2, datë 8.1.2020, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet, Sekretari i Përgjithshëm i MTM-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi